



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujevo

## ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.23.06.2021 nga Operatori Ekonomik, “MEL Engineering”, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “Ndertimi i urave në fshatrat: Bajçinë, Gllamnik, dhe Sfeqël” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1627-5-2-1, nxjerrë këtë:

### VENDIM

1. **Refuzohet** - Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatorit Ekonomik, “MEL Engineering”, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “Ndertimi i urave në fshatrat: Bajçinë, Gllamnik, dhe Sfeqël” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1627-5-2-1, Kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 25.06.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.
2. Vërtetohet Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 25.06.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës..
3. Autoriteti Kontraktues - Qëndron prapa Njoftimit mbi Vendimin e Aktivitetit të Prokurimit dhe kemi vazhduar me hapat e mëtuqjeshëm sipas LPP-ës dhe legjislacionit dytësor të Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetimi

Operatori Ekonomik, “MEL Engineering”, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “Ndertimi i urave në fshatrat: Bajçinë, Gllamnik, dhe Sfeqël” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-1627-5-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 25.06.2021.

Pas analizimit të pretendimit ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë se: Sipas LPP-së, iniciimi i procedurës së Aktivitetit i prokurimit për kriter ka pasur tenderin e përgjegjeshëm me çmim më të lirë dhe pasi nuk është inicuar dhe përcaktuar ndryshe në DT dhe në NJK.

Në bazë të kriterit dhe duke rrejtur buxhetin e komunës AK e ka shpërblyer OE të përgjegjeshëm me çmim më të lirë.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente.

Nr. 04-320/01-0053911/21  
Podujevë,  
05.07.2021



Menaxheri ZP  
Rasim Fejza